

STATUTI I SHOQERISE "KEDINVEST" shpk, emri tregtar KEDINVEST shpk

Ne kete statut:

"Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" ndryshuar

"Statuti" eshte Statuti i Shoqerise

Kreu I

Neni 1:

Data e themelimit, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

(1) Sot me 21 Maj 2024, ne , themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **KEDINVEST shpk**

(2) Themeluesi i shoqerise eshte:

-**Isuf Lika**, me shtetesi Shqiptare, lindur ne Erseke, Shqiperi , me 10.02.1953 dhe banues ne Rruga 17 Shkurti, Pallati 51/1, Ap5, Sarande, Shqiperi , identifikuar me leternjoftimin Nr:034887739 dhe nr.personal F30210114R.

-**Dini Bega**, me shtetesi Shqiptare, lindur ne Poliçan, Shqiperi , me 12.12.1981 dhe banues ne Tirane, Frosina Plaku, Nr.13, Tirane, Shqiperi , identifikuar me leternjoftimin Nr:035319993 dhe nr.personal I11212101I.

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Zyre projekte, investime, konsulence ligjore dhe financiare, projekte ndertimore, turistike.

Shoqeria gjithashtu mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare dhe ndertimore, mbi pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, qe do te vleresohen te nevojshme per realizimine objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesmarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie me te vetin. Te ndermarre veprimtari biznesi si nje shoqeri e pergjithshme financiare dhe tregtare, duke perfshire, por jo duke u limituar vetem ne sherbime web financiare dhe tregtare ne bashkelidhje me njera - tjetren ose si siper marrje te ndara dhe te dalluara te te gjithave ose vetem te ndonjeres nga si me poshte vijon: komisionere, financiere, agjente financiere, kandidat, administrues i besuar, agjent, permbarues, administrator, marres per llogari, ose ne te kundert, ne emer te korporatave private ose publike, shoqerive ose personave. Te siguroje sherbime ne nderlidhje, qofte si biznes i vetem, qofte si biznese te dallueshme dhe te ndara, ne çdo ane te globit. Te ndermarre nje tjetër veprimtari biznesi, e cila, sipas opinionit te Shoqerise, mund te jete e afte per te qene e volitshme apo qe sjell perfitim duke u mbajtur ne bashkelidhje apo si vares me çdo biznes tjetër te Shoqerise dhe qe eshte llogaritur te rrise vleren e pasurise te shoqerise. Te bleje, ose nepermjet çfaredo mjeti tjetër te marre freehold, te marre me qira, te jape me qira, ndonje prone, te zhvilloje kete prone, ose ndryshe duke e kthyer ne avantazh te shoqerise. Te ndermarre nje çfaredo tjetër tregti ose veprimtari biznesi, e cila, sipas opinionit te Asamblese se Ortakeve mund te merret ne menyre perfituese, duke u mbajtur ne bashkelidhje, apo si ndihmese me çdo biznes tjetër te Shoqerise. Te krijoje, bleje ose zoteroje nepermjet çfaredo mjeti tjetër te marre dhe te ndermarre opsione mbi çdo shoqeri, cilado qofte ajo, dhe ndonje te drejte apo privilegj te çfaredo lloji mbi ose ne lidhje me

ndonje shoqeri ane e mbane botes. Te bleje ose nepermjet çfaredo mjeti tjetër te marre dhe ndermarre opsione mbi çdo kompani, cilado qofte ajo, dhe ndonje te drejte apo privilegj te çfaredo lloji mbi ose ne lidhje me ndonje shoqeri ane e mbane botes. Te aplikojë, regjistrojë, blejë, ose nepermjet çfaredo mjeti tjetër te marre dhe te mbrojë, zgjase dhe rinovojë, qofte ne Republiken e Shqiperise ose kudo qofte ne çdo vend te botes, ndonje patente, te drejta mbi patenten, libreze shpikjeje, liçenca, proçese sekrete, marka tregtare, dizajn, mbrojtje dhe proçesione, dhe te padise, pasi ndryshon, perdor dhe te riktheje ne llogari, dhe te prodhojë mbi bazen e liçences ose te jape liçenca dhe privilegje ne lidhje me te njejten gje dhe e shpenzojë para duke eksperimentuar mbi te, duke testuar dhe duke permiresuar ndonje patente, shpikje ose te drejta te cilat shoqeria mund te ndermarre ose propozojë te marre. Te hape ne Republiken e Shqiperise ose kudo qofte ne çdo vend te botes llogari bankare te Shoqerise per qellime tregtare, komerciale dhe qellime investimi ne perputhje me nenet e ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Te jape dhe marre hua dhe paradhenie ne para ose te jape kredi me çfaredo kushtesh me apo pasiguri tek çdo person, firme apo shoqeri, duke perfshire pa paragjykime per gjeneralitetet e meparshme, nje shoqeri meme, filial apo dege, ose çfaredo shoqeri tjetër e asociuar ne çfaredo menyre me Shoqerine, te hyje pale ne garanci, kontrata pa demshperblim ose pranim te te gjitha llojeve, temarre para ne depozite ose hua sipas ndonje kushti, pagesen e ndonje shume parash ose kryerjen e ndonje detyrimi. Te dizenjoj, te beje te pranueshme, te miratojë, zbrese, te negociojë, ekzekutojë dhe te leshojë çeqe, fatura shkembimi, premtimi, ngarkese, urdhra garancie, letra debie, dhe instrumenta te tjere te negociueshem te transferueshem. Te aplikojë, promovojë, dhe te marre çfaredo akti, urdhri apo liçence nga autoritetet shteterore ose nga autoritet tjetër brenda dhe jashte vendit per t'i dhene mundesine shoqerise per te ndermarre veprimtari ne lidhje me objektin.

Shoqeria mund te perfitojë dhe jape donacione nga ente si publike ashtu edhe private, kompani, shoqatave, OJQ-ve si ne Shqiperi ashtu edhe ne te gjithë boten. Mundet gjithashtu te kryejë te gjitha operacionet tregtare, financiare, mobiliare e imobiliare qe eventualisht konsiderohen te nevojshme dhe oportune per te arritur ose nxitur permbushjen e objektit social.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

Neni 4

Selia

Selia e shoqerise do te jete ne: **Rruga 17 Shkurti, Pallati 51/1, Ap5, Sarande, Shqiperi**. Per qellime te komunikimit elektronik do te jete adresa erislika@gmail.com Tel: +355694649993.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 (Njeqind) leke. Ky kapital do te ndahet ne 2 (dy) kuota. Pjesemarrja e themeluesve ne kapital eshte ne perputhje me kontributet e tyre si me poshte:

1. Ortaku themelues **Isuf Lika** do te zoteroje 1(nje) kuote qe i perkasin **67 %** te kuotave te kapitalit te pergjithshme, me vlere nominale 67 leke.
2. Ortaku themelues **Dini Bega** do te zoteroje 1(nje) kuote qe i perkasin **33 %** te kuotave te kapitalit pergjithshme, me vlere nominale 33 leke

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Ne cdo rast rritja apo zvogelimi i kapitalit do te behet me aprovimin e te gjithe ortakeve te kompanise.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 75 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 75 për qind total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Përgjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:
(mbiemrat, emrat, adresat):

dhe specimenët e nënshkrimit:

Eris Lika 

-Eris Lika, shtetas shqiptar, atesia Isuf, lindur me 03.04.1982, në Korçë, banues në Rruga Islam Alla, Nd5,H5, Ap14, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim me nr. 034686417 dhe nr. personal I20403233T.

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



 326

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Në çdo rast mund të emerohet një administrator i dytë nëse ndonjeri nga ortakët e kërkon kur ky ortak kërkues zoteron më shumë se 25% të kuotave të kapitalit.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 **Përgjegjësi e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të

rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.


Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendiimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

KEDINVEST shpk

Isuf LIKA

Dini BEGA